



Falja e namazit

për fillestarë

me përkthim të lutjeve

Krijuesi ynë, All-llahu thotë:

14. Ka shpëtuar ai që është pastruar,
15. Që ka përmendur emrin e Zotit të vet dhe që është falur,
16. Por ju i jepni përparësi jetës së kësaj bote,
17. Ndërsajeta tjetër është më e mirë dhe e pérherëshme!"

(ajete nga sureja A'LA)

1. Kanë shpëtuar besimtarët,
2. Të cilët gjatë namazit janë të përulur...
9. Dhe të cilët e ruajnë namazin e tyre
10. Të tillët janë trashigimtarët
11. Trashiguesit e Firdeusit, ku do të banojnë përgjithmonë.

I dërguari i Fundit, Muhammedi a.s. ka thënë:

"Gjëja e parë për të cilën do të japë llogari robi (i All-llahut) në Ditën e Ringalljes është namazi. Nëse i ka kryer namazet sipas rregullave, atëherë do të jetë i shpëtuar dhe ka korrur sukses. Nëse namazet do të jenë të paplota (të mangëta), do të përjashtohet nga mirësia dhe do të jetë i humbur. Nëse do të ketë diçka të paplotësuar nga farzet (obligimet e

domosdoshme), All-llahu i Lartmadrëuar do t'u thotë (melekëve):

-Shihni se a ka kryer robi Im ndonjë namaz vullnetar, me të cilin do t'ia kisha plotësuar farzin.

Pastaj edhe veprat tjera do të gjykohen në të njëjtën mënyrë."

Gjithashtu ka thënë:

"...Shtylla e fesë është namazi..."

Dhe:

"...Islam është:

1. Të dëshmosh se s'ka hyjni tjetër pos All-llahut dhe se Muhammedi është i dërguari i Tij;
2. Ta kryesh faljen;
3. Ta japist zekatin;
4. Ta agjërosh muajin Ramadan dhe
5. Ta kryesh haxhin nëse ke mundësi."

Kushtet për vlefshmërinë e namazit

-Nuk bën të jesh xhunub - i (e) papastruar nga përjetimi seksual ose (vlen vetëm për femrat) e papastruar nga periudha mujore. Që të pastrohesh, duhetta lash tërë trupin.

-Nuk bën ta kesh kryer nevojën (qoftë të madhen ose të voglën) dhe të mos e kesh larë vendin me ujë. Nëse je stërpikur (ndotur) me nevojë, duhet ta lash teshën ose të veshish tjetër.

-Namazi nuk vlen pa marrë *abdest*. **Abdesti** mirret kështu: Duke patur për qëllim marrjen e abdestit, thua **Bismil-lah** dhe i lan nga tre herë: duart, gojën, hundën, fytyrën, krahët deri në bërryl, i fërkon me dorë të lagët flokët dhe veshët, dhe i lan këmbët deri te nyjet.

-Me një abdest mund të falen disa namaze, ndërsa abdestin e prishin kryerja e nevojës, lëshuarja e gazit, gjumi, etj.

-Gjatë faljes mashkulli duhet ta ketë të mbuluar trupin së paku prej kërthizës deri te gjunjët, ndërsa femra duhet ta mbulojë tërë trupin, pos fytyrës dhe duarve.

-Para se ta fillosh faljen, kthehet kah Kabja dhe vendosesh para ndonjë *sutre* (sutre mund të jetë muri, druri, shpina e njeriut, guri pak më i madh ose ndonjë objekt tjetër jo i gjallë).

-Gjatë faljes ndalohet të folurit, të qeshurit, të shikuarit lartë ose anash dhe e gjithë kjo ka për qëllim koncentrimin sa më të madh të falësit, sepse ai vendos kontakt me Krijuesin e tij, i Cili meriton lavd-falënderim dhe frikërespekt të denjë.

-Para se të fillosh faljen, duhet të kesh për qëllim faljen e kohës së caktuar. Nëse të ndodh që ta falish ikindinë, ndërsa për qëllim ke patur faljen e drekës, duhet ta përsërisish namazin.

-Namazin e falë në kohën e vetë.

Kohërat e faljes

1. **Sabahu** (*Fexhr*) falet në agim, prej kur fillon dallimi mes errësirës së natës dhe dritës së zbehtë të mëngjesit, dhe vazhdon deri para lindjes së diellit.
2. **Dreka** (*Dhuhr*) falet pasi që dielli lëviz prej zenitit, deri në atë pozitë kur hija e objektit fiton gjatësinë e objektit.
3. **Ikindia** (*'Asr*) falet pas mbarimit të drekës dhe vazhdon deri para perëndimit të diellit.
4. **Akshami** (*Magrib*) fillon pas perëndimit të diellit deri në errësimin e horizontit.
5. **Jacia** (*'Isha*) falet pasi që horizonti errësohet plotësisht, deri para agimit.

Jepet Falas!

Tabela e rekateve

Namazi përbëhet nga pjesët e quajtura **reka**.

Në vazhdim po tregojmë nga sa rekate kanë namazet:

rekate namazi	Sunnet	Farz	Sunnet	Vitri
Sabahu	2	2		
Dreka	4	4	2	
Ikindia	(4)	4		
Akshami		3	2	
Jacia	(4)	4	2	3

Çdo namaz, qoftë farz ose sunnet falet për hir të Zotit dhe askujt jetë.

Namazet farz janë obligim nga Zoti për çdo musliman të vetëdijshëm, dhe përmosfalen e tyre pa shkak pasion dënim i në këtë jetë dhe pas vdekjes.

Namazet sunnet është mirë që të falen ngase ato i ka falur edhe Muhammedi a.s. gjithmonë kur ka patur mundësi. Në tabelë janë cekur 12 rekate sunnet që Muhammedi a.s. zakonisht i ka falur dhe e ka lavdëruar faljen e tyre duke thënë: "Çdo musliman që vullnetarisht falë 12 rekate gjatë ditës për hir të All-lahut pos farzeve, All-lahu do t'i ndërtojë një shtëpi në Xhennet." Ndërsa në një rast ai ka thënë: "Këtë rekate para dreke, dy pas dreke, dy pas akshamit, dy pas jacisë dhe dy para sabahut". Transmetohet se ai ka falur namaz edhe pas ikindisë dhe para akshamit. Ai ka thënë: "Ndërmjet çdo ezani dhe ikameti ka namaz" dhe këtë e ka përsëritur 3 herë, pastaj ka thënë: Për atë që dëshiron."


Namazi i vitrit nuk është mirë të lihet pa falur, edhe pse nuk është farz. Muhammedi a.s. atë nuk e ka lënë pa falur.

Përveç këtyre namazeve, Muhammedi a.s. ka falur edhe namaze të tjera vullnetare, si për shembull është çuar natën dhe ka falur namaz nate, ose ka falur namaz pas lindjes së diellit, ose kur është zënë dielli, ndërsa ndonjëherë ka falur namaz para se të ndërmarrë ndonjë vendim të rëndësishëm për ndonjë çështje të kësaj bote. Këto janë namaze vullnetare dhe kryerja e tyre edhe pse nuk është e domosdoshme, çmohet shumë.

REKATI I PARË

1 I ngren duart dhe thua:

ALL-LLAHU EKBER



All-lahu është më i Madhi



2 E vëndon dorën e djathjtë mbi të majtën dhe thua:

**SUBHANEKE ALL-LLAHUMME WE BI HAMDIKE
WE TEBAREKESMUKE WE TE'ALA XHEDDUKE
WE LA ILAHE GAJRUKE
E'UDHU BIL-LAHI MINESH-SHEJTANIR-RAXHIM**

Dëlirësia të takon Ty, Zoti im, dhe falënderimi, emri Yt është i bekuar, e lartësuar është Madhështia Yte, s'ka hyjni pos Teje

Mbështetem në All-lahun nga djalli i mallkuar

FATIHA

KEWTHER

1. BISMIL-LAHIR-RAHMANIR-RAHIM
2. EL HAMDULIL-LAHI RABBIL 'ALEMIN
3. ER-RAHMANIR-RAHIM
4. MALIKI JEWMDID-DIN
5. IJJAKE NA'BUDU WE IJJAKE NESTA'IN
6. IH DINAS-SIRATAL MUSTEKIM
7. SIRATAL-LEDHINE EN 'AMTE 'ALEJHIM,
GAJRIL MAGDUBI 'ALEJHIM WE LED-DAL-LIN (AMIN)

BISMIL-LAHIR-RAHMANIR-RAHIM

1. INNA A'TAJNA KEL KEWTHER
2. FE SAL-LI LI RABBIKE WEN HAR
3. INNE SHANIEKE HUWEL EBTER

1. Me emrin e All-lahut, Mëshiruesit, Mëshirëbëresit
2. Falënderimi i takon All-lahut, Zotit të botërave
3. Mëshiruesit, Mëshirëbëresit
4. Sunduesit të ditës së Gjykit
5. Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë
6. Udhëzona në rrugën e drejtë,
7. në rrugën e atyre ndaj të cilëve ke bekimin, e jo në të atyre që je i hidhëruar, dhe që kanë humbur! (Amin)

Kjo është sureja (kaptina e Kur'anit) Fatiha, e cila duhet doemos të thuhet gjatë faljes së namazit

- Me emrin e All-lahut, Mëshiruesit, Mëshirëbëresit
1. Vërtet Ne të dhamë ty të Mirën (e pashtershme)
 2. Pra falu për Zotin tënd dhe sakrifiko
 3. Vërtet urejtësi yt është farësosur.

Kjo është sureja Kewther, në vend të së cilës mund të thuhet ndonjë sure tjetër e Kur'anit



I Dëlirë është Zoti im Madhështor



All-lahu dëgjon atë që e falënderon




Zoti ynë, Ty të takon falënderimi



I Dëlirë është Zoti im i Lartë



Zoti im, falmë, falmë



I Dëlirë është Zoti im i Lartë

3 Duke thënë: **ALL-LLAHU EKBER** kërrusesh dhe i ven duart mbi gjunj. Në këtë pozitë (e cila quhet ruku) thua tre herë:

SUBHANE RABBIJEL 'ADHIM

4 Duke thënë:

SEMI' ALL-LLAHU LIMEN HAMIDEH
drejtohesh dhe thua:

RABBENA LEKEL HAMD

5 Thua **ALL-LLAHU EKBER** dhe përulesh me ballë në tokë. Në këtë pozitë (e cila quhet sexhde) thua tre herë:

SUBHANE RABBIJEL A'LA

6 Thua **ALL-LLAHU EKBER** dhe ulesh.

Në këtë pozitë thua:

RABBI GFIRLIJ, GFIRLIJ

7 Thua **ALL-LLAHU EKBER** dhe e bën edhe një sexhde duke thënë përsëri tre herë

SUBHANE RABBIJEL A'LA

8 Thua **ALL-LLAHU EKBER** dhe çohesh në këmbë për rekatin e dytë.

REKATI I DYTË

9 Përsëri e vëndon dorën e djathtë mbi të majtën dhe e thua suren **FATIHA** (shih veprimin 2), ndërsa pas saj suren **IHLAS**:

BISMIL-LAHIR-RAHMANIR-RAHIM

1. KUL HU WALL-LLAHU EHAD
2. ALL-LLAHUS-SAMED
3. LEM JELID WE LEM JULED
4. WE LEM JEKUN L-LEHU KUFUWEN EHAD



- Me emrin e All-lahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit
1. Thuaj: Ai, All-lahu është Një
 2. All-lahu është Strehuesi
 3. S'ka lindur kë, as nuk është i lindur
 4. Dhe Atij askush nuk i përqjan

Edhe në vend të kësaj sureje mund të zgjidhet ndonjë surejtë

IHLAS



Pas kësaj, si në rekatin e parë kërrusesh, drejtohesh dhe i bën dy sexhde (d.m.th. i përsërit veprimet 3,4,5,6 dhe 7).

10 Pas sexhdes së dytë tha **ALL-LLAHU EKBER**, ulesh dhe thua:

**ET-TEHIJJATU LIL-LAHI WES-SALAWATU WET-TAJJIBATU
ES-SELAMU 'ALEJKU EJJUHEN-NEBIJU
WE RAHMETULL-LLAHI WE BEREKATUHU
ES-SELAMU 'ALEJNA WE 'ALA 'IBADIL-LAHIS-SALIHIN
ESH HEDU EN LA ILAHE IL-LALL-LLAH
WE ESH-HEDU ENNE MUHAMMEDEN 'ABDUHU WE RESULUHU**

Përshëndetjet i takojnë All-lahut, si dhe lutjet dhe fjalët e mira Paqja qoftë mbi ty, o Lajmëtar, si dhe mëshira e All-lahut dhe begatitë e Tij Paqja qoftë mbi ne dhe mbi të gjithë robërit e mirë të All-lahut Dëshmoj se s'ka hyjni tjetër pos All-lahut dhe se Muhammedi është robi dhe i dërguar i Tij

11 PËRFUNDIMI I NAMAZIT:

I ulur tha:

**ALL-LLAHUMME SAL-LI 'ALA MUHAMMEDIN
WE 'ALA ALI MUHAMMED
KEMA SAL-LEJTE 'ALA IBRAHIME WE 'ALA ALI IBRAHIM
INNEKE HAMIDUN MEXHID
ALL-LLAHUMME BARIK 'ALA MUHAMMEDIN
WE 'ALA ALI MUHAMMED
KEMA BAREKTE 'ALA IBRAHIME WE 'ALA ALI IBRAHIM
INNEKE HAMIDUN MEXHID**

O All-lahu im, bekoje Muhammedin dhe familjen e tij, siq e bekove Ibrahimin dhe familjen e tij, Ti je i Falënderuar dhe i Lartësuar.

O All-lahu im, begatoje Muhammedin dhe familjen e tij, siq e begatove Ibrahimin dhe familjen e tij, Ti je i Falënderuar dhe i Lartësuar.

SALAWAT

**ALL-LLAHUMME RABBENA ATINA FID-DUNJA HASENETEN
WE FIL-AHIRETI HASENETEN WE KINA 'ADHABEN-NAR.
RABBENA GFIRLI WE LI WALIDEJJE WE LIL-MU'MININE
JEWME JEKUMUL HISAB**

O All-lahu im, Zoti ynë, na jep të mira në këtë botë dhe në botën tjetër, dhe na ruaj nga dënimë me zjarr. Zoti ynë, më fal mua, prindërit e mi dhe besimtarët ditën kur do ta japim llogarinë.

Në vend të kësaj lutjeje mund të thuhet ndonjë tjetër nga lutjet e Lajmëtarit a.s.

12 Namazi përfundon me dhëni e **SELAMIT**:

e kthen kokën së pari në të djathtë dhe thua:

ES-SELAMU 'ALEJKUM WE RAHMETULL-LLAH
dhe në të majtë:
ES-SELAMU 'ALEJKUM WE RAHMETULL-LLAH



Paqja dhe mëshira e All-lahut qofshin mbi ju

Paqja dhe mëshira e All-lahut qofshin mbi ju

FALJA E DREKËS, IKINDISË DHE JACISË

Këto namaze kanë nga katër rekate. Duke patur për qëllim (nijet) faljen e namazit përkatës, i fal dy rekabet e para njëlloj si në namazin e sabahut deri në veprimin 10, ndërsa pas lutjes **ET TEHIJATU** duke thënë **ALL-LLAHU EKBER** çohesh në këmbë për rekatin e tretë.

REKATI I TRETE

13 I lidh duart dhe e thua vetëm suren **FATIHA**. Pastaj e kryen rukun, drejtohesh, i bën dy sexhde dhe duke thënë **ALL-LLAHU EKBER** çohesh në këmbë (si në veprimet 3,4,5,6,7 dhe 8).

REKATI I KATËRT

14 Edhe në këtë rekat e thua vetëm suren **FATIHA**, e kryen rukun, drejtohesh, i bën dy sexhde (veprimet 3,4,5,6,7 dhe 8) dhe në fund ulesh dhe e përfundon namazin me lutjet **ET TEHIJATU, SALAWAT** dhe **LUTJEN KUR'ANORE** dhe në fund jep **SELAMIN** (veprimet 10,11,12).

FALJA E SUNETEVËS

Akshami ka tre rekate. Duke patur për qëllim faljen e tij i fal tre rekabet e para njëlloj si tre rekabet e drekës, ndërsa pas kësaj nuk çohesh për rekatin e katërt, por ulesh duke thënë **ALL-LLAHU EKBER** dhe e përfundon namazin duke i thënë lutjet: **ET TEHIJATU, SALAWAT, LUTJEN KUR'ANORE** dhe jep **SELAMIN** (si në veprimet 10, 11 dhe 12).

FALJA E SUNETEVËS

Falja e suneteve dy rekateshe bëhet si falja e sabahut, ndërsa falja e suneteve katër rekateshe bëhet si falja e drekës, me atë që duhet patur për qëllim (nijet) faljen e tyre.

Pasqyra e lutjeve që thuhen gjatë faljes së farzeve

Namazi Rekati	Sabahu	Dreka	Ikindia	Akshami	Jacia
1	Subhanek Eudhubilahi Fatiha (Kewther)	Subhanek Eudhubilahi Fatiha (Kewther)	Subhanek Eudhubilahi Fatiha (Kewther)	Subhanek Eudhubilahi Fatiha (Kewther)	Subhanek Eudhubilahi Fatiha (Kewther)
2	Fatiha (Ihlas) <small>Et-Tehijatu SELAMI</small>	Fatiha (Ihlas) <small>Et-Tehijatu</small>	Fatiha (Ihlas) <small>Et-Tehijatu</small>	Fatiha (Ihlas) <small>Et-Tehijatu</small>	Fatiha (Ihlas) <small>Et-Tehijatu</small>
3		Fatiha	Fatiha	Fatiha <small>Et-Tehijatu SELAMI</small>	Fatiha
4		Fatiha <small>Et-Tehijatu SELAMI</small>	Fatiha <small>Et-Tehijatu SELAMI</small>		Fatiha <small>Et-Tehijatu SELAMI</small>

Ezani dhe Ikameti

Ezani	Ikameti	Ezani thuhet para fillimit të namazit, ndërsa ikameti para fillimit të farzeve
4 4 ALL-LLAHU EKBER		All-llahu eshtë më i Madhi
2 2 ESH-HEDU EN LA ILAHE IL-LALL-LLAH		Dëshmoj se s'ka hyjni tjetër pos All-llahut
2 2 ESH-HEDU ENNE MUHAMMEDER-RESULULL-LLAH		Dëshmoj se Muhammedi eshtë i dërguar i All-llahut
2 2 HAJJE 'ALES-SALAH		Eja në falje
2 2 HAJJE 'ALEL-FELAH		Eja në shpëtim
2 - ES-SALATU HAJRUN MINEN-NEWM (vetëm në sabah)		Falja eshtë më e mirë se gjumi
- 2 KAD KAMETIS-SALAH		Falja filloj
2 2 ALL-LLAHU EKBER		All-llahu eshtë më i Madhi
1 1 LA ILAHE IL-LALL-LLAH		S'ka hyjni tjetër pos All-llahut

Përkthimi

4 4 ALL-LLAHU EKBER	
2 2 ESH-HEDU EN LA ILAHE IL-LALL-LLAH	
2 2 ESH-HEDU ENNE MUHAMMEDER-RESULULL-LLAH	
2 2 HAJJE 'ALES-SALAH	
2 2 HAJJE 'ALEL-FELAH	
2 - ES-SALATU HAJRUN MINEN-NEWM (vetëm në sabah)	
- 2 KAD KAMETIS-SALAH	
2 2 ALL-LLAHU EKBER	
1 1 LA ILAHE IL-LALL-LLAH	

All-llahu eshtë më i Madhi
Dëshmoj se s'ka hyjni tjetër pos All-llahut
Dëshmoj se Muhammedi eshtë i dërguar i All-llahut
Eja në falje
Eja në shpëtim
Falja eshtë më e mirë se gjumi
Falja filloj
All-llahu eshtë më i Madhi
S'ka hyjni tjetër pos All-llahut

Disa nga thëniet e Muhammedit a.s. rreth faljes

-Çka mendoni, sikur të ishte një lumë para derës së ndonjërit prej jush, në të cilin do të lajep për çdo ditë nga pesë herë, a do të mbetej në të ndytës? Thanë: -Nuk do të mbetej kurfarë ndytësie. Lajmëtarë a.s. tha: -Ky eshtë shembulli i pesë kohëve të namazit. All-llahu me faljen e namazeve i shlyen mëkatet. (579)

-Pesë namazet prej njërit deri te tjetri, namazi i xhumasë prej njërit deri te tjetri dhe prej një ramazani gjer në ramazanin tjetër, janë pastrues të mëkateve në mes tyre, nëse ruheni prej mëkateve të mëdha. (96)

Abdull-llah ibn Mes'udi r.a. ka thënë: -E kam pyetur të Dërguarin a.s.: Cila punë eshtë më e dashur te All-llahu i Madhëruar? Tha: Namazi në kohën e vet. -I thashë: Pastaj cila? Tha: -Bamirësia ndaj prindërve. -I thashë: Pastaj cila? Tha: -Xhihadi në rrugë të All-llahut. (205)

Një njeri ka thënë: -O i Dërguar i All-llahut, më trego për një punë që do të më shpie në Xhennet dhe do të më largojë nga Xhehennemi! I Dërguari a.s. tha: -Ta adhurosh All-llahun dhe të mos i shoqërosh asgjë, ta falësh namazin, ta ndash zekatin dhe t'i mbash lidhjet farefisnore. (214)

-A dëshironi t'ju tregoj se me çka All-llahu i shlyen mëkatet e juaja dhe me çka i lartëson gradat tuaja? Të pranishmit i thanë: -Po, o i Dërguari i All-llahut! I Dërguari a.s. u tha: - Marrja e abdestit edhe atëherë kur eshtë

vështirë, shkuarja e shpeshtë në xhami dhe pritja e namazit pas namazit. Kjo eshtë fortifikatë, kjo eshtë fortifikatë. (572)

-Namazi i njeriut në xhemat eshtë më i vlefshëm se namazi i tij në shtëpinë e tij apo diku tjetër për njëzet e disa shkallë. Kush merr abdest në formën më të mirë, pastaj shkon në xhami me të vetmin qëllim që ta falë namazin në xhemat, duke mos i interesuar asgjë tjetër, për çdo hap të tij i shtohet nga një gradë dhe i shlyhet nga një mëkat derisa të hyjë në xhami, e kur të hyjë në xhami, atëherë në namaz eshtë aq sa i ka marrë kohën namazi. Secilin prej jush e bekjnë engjëjt, derisa të gjendet në vendin ku eshtë falur namazi, ata thonë: "O Zot, mëshiroje! O Zot, pale! O Zot, pranoja pendimin". Engjëjt veprojnë kështu përderisa njeriu të mos fillojë t'u pengojë të tjerëve, apo ta prishë abdestin në xhami. (8)

-Kush e fal namazin e jacisë me xhemat, eshtë sikurse ai që gjysmën e natës e kaloi në namaz. Ndërsa ai, që e fal namazin e sabahut me xhemat, eshtë sikurse ai i cili eshtë falur tërë natën. (591)

Aisheja r.a. ka thënë: I Dërguari a.s. çohej natën (dhe falej) aq gjatë saqé këmbët iu patënën enjtur, andaj unë i thashë: Përsë po vepron kështu o i Dërguar i All-llahut, kur t'i ka falur ty All-llahu mëkatet e mëparshme dhe të pastajmet? Ai tha: A të mos jem rob falënderues? (70)

-Kush merr abdest burkur e mirë, pastaj shkon në namaz të xhumasë, atje hesht dhe dëgjon (hutben), i falen mëkatet e bëra ndërmjet dy xhumave dhe tri ditë më tepër. Kush argëtohet në xhami me rërë (dhe gjëra të tjera), e ka zhvlerësuar dobinë e xhumasë. (94)

-Zotimi i cili na ndan neve dhe ata (pabesimtarët) eshtë namazi, andaj ai që e lë atë ka bërë mosbesim. (97)

-Për dyfyrëshit nuk ka namaz më të rendë se namazi i sabahut dhe i jacisë, e sikur ta dinin se çka ka në ta, do të vinin në xhemat në këto dy namaze edhe rrëshqanas. (93)

-Kush e fal namazin e sabahut, eshtë nën mbrojtjen e All-llahut, andaj mos i kundërvihet askush kësaj me diçka, sepse kush i kundërvihet kësaj, All-llahu do ta arriju atë, dhe pastaj do ta gjuajë me fytyrë në zjarr të Xhehennemit. (245)

-Kush e lë namazin e ikindisë, i humb e tèrë puna e tij. (583)

-Urdhëroni fémijët tuaj për namaz kur t'i kenë shtatë vjet, kurse detyroni me forcë (rrihni) kur t'i bëjnë dhjetë vjet dhe ndajini në shtrëtë (të veçantë). (199)

Marrë nga përbledhja e haditheve "Rijadus-Salihin" (versioni i xhepit)

Lavd-falënderimi i takon All-llahut, qoftë paqja mbi të Dërguarin e Tij dhe mbi të gjithë besimtarët